



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo

DALESE - IZLAZNA - OUTGOING  
REPUBLICA E KOSOVES, REPUBLIKA KOSOVA, REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT  
KOMUNA HANI I ELEZIT, OPSTINA HANI I ELEZIT, MUNICIPALITY HANI I ELEZIT  
Nr./ Faq: 02 / 2846 Data: 07.05.2013  
HANI I ELEZIT



Komuna Hani i Elezit  
Municipality of Elez Han

02/2846/2013

Data:	03.05.2013
PËR :	Departamenti Ligjor i MAPL-së z. Agron Maxhuni
PËRMES:	Kryetari i Komunës Rufki Suma
NGA :	Shefi i Zyrës Ligjore Bajrush Laçi
LËNDA:	Vendimet e Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit për muajin PRILL

I nderuar z.Maxhuni;

Duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës me nr. 03/L-040, përkatësisht neni 80 nënparagrafi 80.1, dërgojmë për shqyrtim të rregullt këto vendime të Kuvendit të Komunës siç vijojnë:

1. Vendim për MIRATIMIN e raportit tre mujor të shpenzimeve për vitin 2013 me numër 01.Nr.2213/2013
2. Vendim për dhënien e pëlqimit në parim për hapjen e rrugës për kompaninë sh.p.k. "Guri i Bekuar", me numër 01.Nr.1867/2013

Me respekt.



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Hani i Elezit

*01/Nr.2213 /2013*

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2013 mori:

**VENDIM  
PËR**

**MIRATIMIN E RAPORTIT TRE MUJOR TË SHPENZIMEVE PËR VITIN 2013**

**I**

Miratohet raporti tre mujor i shpenzimeve buxhetore për vitin 2013.

**II**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar-Mars 2013 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në këtë raport përfshihen:

- Implementimit i buxhetit për periudhën janar - mars 2013
- Progresi i shpenzimeve
- Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik
- Planifikimi i buxhetit, alokimit dhe shpenzimet
- Pagat dhe kompensimet tjera
- Raport i të hyrave vetanake sipas programeve
- Përmbledhja e shpenzimeve në mallra dhe shërbime
- Shërbimet komunale - komunalitë
- Subvencionet dhe transferet
- Financimi vjetor i investimeve kapitale për periudhën janar - mars 2013

**III**

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

**IV**

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit  
Data:29.04.2013

Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlashi





Republika e Kosovës  
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr.1867/2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-25 neni 8, shkresës përcjellëse me numër 11/Nr.2633/2013 të datës 22.04.2013 nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, procesverbalin e komisionit të komunës. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2013 mori:

## V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KOMPANIN SH.P.K „GURI I BEKUAR” PËR HAPJEN E RRUGËS

### I

I jepet në parim pëlqimi kompanisë sh.p.k., „Guri i Bekuar” për hapjen e rrugës në paramas 4 deri 5 m nëpër parcelat kadastrale me numër nr.294-0 me kulturë mal i klasit 5, nr.295-0 me kulturë mal i klasit 5, nr.296-0 me kulturë kullos e klasit 7 në vendin e quajtur Kodra sipas çertifikatës së pronësisë me numër nr.125 e evidentuar në emër të P.SH EKONOMIA E PYJEVE zona kadastrale Seçishtë.

### II

Komuna e Hanit të Elezit në parcelën e lartë shënuar nuk ka plan rregullativ hapësinor, kurse pala për dokumentacionet e tjera të nevojshme duhet të drejtohet në Agjensionin e Pyjeve të Republikës së Kosovës pasi që prona e kërkuar është e ekonomisë pyjore.

### III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

### IV

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Pala, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 29.04.2013

Kryesuesi i Kuvendit

Menduh Vlasi

